



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/55
Datë: 06.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Trashëgiminë Kulturore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministravox Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

KONCEPT DOKUMENTIPËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Kapitulli 1: Hyrje

Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mbetet në vazhdimësi prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës si sektor i veçantë me rol kyç ne zhvillimin e shtetit . Plotësimi dhe avancimi i komizës ligjore dhe infrastrukturore konform praktikave dhe standardeve ndërkombëtarë mbetet prioritet i përcaktuar edhe në *Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018.*

Fushat e trashëgimisë kulturore dhe mbështetjes institucionale të saj, paraqiten në kuadër të Vizionit Programor 2017-2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, e më specifikisht në kuadër të shtyllës së katërt *Zhvillimi Sektorial*. Në kuadër të kësaj shtylle përmendet dhe krijimi i kushteve ku vlerat kulturore dhe artistike gjajnë afirminim e duhur. Siç ceket në dokumentin në fjalë: “Investimet në kulturë nuk janë vetëm promovim i vlerave dhe identitetit tonë. Në një të ardhme të afërt ato do të shndërrohen në gjenerues të të hyrave për shoqërinë dhe shtetin, si dhe aset i fuqishëm për studim dhe krijim”, duke dëshmuar kësijo për rëndësinë dhe njëherazi përkushtimin institucional për mbështetjen dhe avancimin e sektorit te Trashëgimisë Kulturore.

Hartimi i Koncept Dokumentit për Trashëgiminë Kulturore është paraparë me *Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2018* si dhe në kuadër të *Listës së Koncept Dokumenteve për vitin 2017*. Sipas *Komizës Afatimesme të Shpenzimeve 2017-2019* “Trajtimi i trashëgimisë kulturore duhet bërë në mënyrë të integruar, si trashëgimia arkitekturelle, trashëgimia shpirtore, ajo arkeologjike, peizazhet kulturore si dhe të gjitha asetat nën mbrojtje të shtetit duhet të mbrohen, ruhen, studiohen e promovohen sa më shumë dhe të bëhen objekte të hartës turistike të Republikës së Kosovës”.

Mbrojtja dhe ruajtja e pronave, objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe përcaktimi i masave ligjore dhe teknike për inventarizim, hulumtim, dokumentim, përzgjedhje, konservim, restaurim, prezantim dhe promovim të trashëgimisë kulturore në pajtim me kartat, konventat dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare është përcaktuar si prioritet në *Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore*.

Për më tepër masat e përfshira në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore dhe që adresojnë komizën ligjore parashohin kompletimin dhe harmonizimin sistematik të legjislacionit të trashëgimisë kulturore me ligjet tjera të Kosovës dhe me ato të BE-së si dhe zbatimin efektiv të politikave të trashëgimisë kulturore.

Lidhur me rëndësinë dhe prioritizimin e trashëgimisë kulturore e posaçërisht bashkëpunimit kulturor vlen të përmendet edhe Nenin 108 për Bashkëpunim Kulturor në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, ku ndër të

tjera përmendet “fuqizimi i kapaciteteve të politikës kulturore, forcimi i kapacitetit të operatorëve kulturore dhe përmirësimi i mirëkuptimit të ndërsjellët midis individëve, minoritetave dhe popuje. Bashkëpunimi gjithashu do të mbështet reformat institucionale për të nxitur shumëlojshmërinë kulturore, veçanërisht në bazë të parimeve në kuadrin e Konventës së UNESCO-s përmbrojten dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore, të miratuar në Paris me 20 tetor 2005.¹

Lidhur me këtë dhe në funksion të konsultimit të dokumenteve strategjike dhe obligimeve ligjore në kontekst të procesit të integrimit Evropian në fushën e trashëgimisë kulturore, janë konsultuar një mori dokumentesh e instrumentesh ligjore sikurse Traktati i Lisbonës i cili i jep rëndësi më të madhe kulturore; preambula e Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) shprehimisht i referohet “marrjes së frymëzimit nga trashëgimia kulturore, fetare dhe humaniste të Evropës”. Një prej qëllimeve kryesore të BE-së, siç përcaktohet me Traktat, është që “të respektojë larminë kulturore dhe gjuhësore, si dhe [...] që të sigurojë që trashëgimia kulturore e Evropës të mbrohet dhe të avancohet” (neni 2 TBE); Agjenda Evropiane për Kulturë dhe objektivat e saja (diversiteti kulturore dhe dialogu ndërkulturore; kultura si katalizator i krijimitarisë; si dhe kultura si komponent kyç i marrëdhënieve ndërkombëtare. Në grupimin e parë të objektivave, BE-ja dhe palejt tjetra relevante (në veçanti Këshilli i Evropës dhe UNESCO) kanë shprehur gatishmërinë për të punuar së bashku në nxitjen e dialogut ndërkulturore, me qëllim që të sigurohet që diversiteti kulturore të kuptohet, të respektohet e të promovohet. Promovimi i kulturës, si katalizator për krijimtari, në kuadër të Strategjisë së Lisbonës përritje dhe vende pune, si dhe strategjinë përcjellëse të saj, Evropë 2020), obligimet e dala nga Plani i Veprimit përzbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimil sikurse dhe konkluzionet nga takimet e Nën Komitetit për Inovacion, Shoqëri Informative dhe Politika Sociale.

Hartimi i këtij koncept dokumenti si një ndër masat e shumta (legjislative dhe zbatuese në fushën e trashëgimisë kulturore), koincidon dhe me fillimin e Viti Evropian të Trashëgimisë Kulturore 2018, viti tematik i BE-së, i cili do të vendosë në qendër të vëmendjes trashëgiminë kulturore të Evropës.

Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore 2018 synon të rrissë ndërgjegjësimin për historinë dhe vlerat evropiane dhe për të forcuar një ndjenjë të identitetit evropian. Në të njëjtën kohë, tërheq vëmendjen ndaj sfidave me të cilat ballafqohet trashëgimia kulturore, siç janë ndikimi i zhvendosjes digitale, presioni mjesidor dhe fizik në vendet e trashëgimisë dhe trafikimi i paligjshëm i objekteve kulturore. Objektivat kryesore të këtij Viti Evropian janë: promovimi i diversitetit kulturor, dialogut ndërkulturore dhe kohezionit social; kontributi ekonomik i trashëgimisë kulturore në sektorët kulturore dhe krijues, duke përfshire ndërmarrjet e vogla dhe të

¹Neni 108 Bashkëpunimi kulturor

Palët ndërmarrin masa për promovimin e bashkëpunimit kulturor. Ky bashkëpunim duhet te shërbej te fuqizohen kapacitetet e politikave kulturore te Kosovës, kapacitetet e operatoreve kulturore dhe ngritjen e mirëbesimit ndërmjet individëve, minoritetave dhe njëzetëve. Bashkëpunimi gjithashtu duhet te mbështes reformën institucionale që te promovoj diversitetin kulturor ne Kosove, duke përfshire principet themelore ne Koventen e UNESCO-s përmbrrojtjen dhe promovimin e shprehjeve të diversitetit kulturor, miratuar në Paris me 20 tetor 2005.

mesme dhe në zhvillimin lokal dhe rajonal; roli i trashëgimisë kulturore në diplomacinë kulturore evropiane si dhe rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë së përbashkët kulturore.

Në këtë drejtim, Ministria e Kulturës, Rinasë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë tek prioritet strategjike respektivisht objektivi Avancimi i kornizës ligjore dhe politikave në fushën e trashëgimisë kulturore ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Trashëgiminë si një mundësi e adresimit të çështjeve të identifikuara sikurse definimi i nacioneve në kontekstin e ligjit; inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e përkohshme e trashëgimisë kulturore; mbrojtja dhe masat legale; obligimet e personave juridik dhe fizik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkatesisht definimit normativ e trajtim addekuat të tyre.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, përkatesisht gjatë zbatimit të këtij Ligji janë hasur disa vështirësi si rezultat i mangësive dhe paqartësive të disa dispozitave. Për këtë arsyё eshtë parë i domosdoshëm plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit aktual.

Plotësimi dhe ndryshimi i ligjit duhet të parashesh dhe përcaktojë qartë rolet e përgjegjësitë e institucioneve ekzistuese të trashëgimisë kulturore kashi atyre që parashihen të themelohen me këtë ligj të ri. Në ligjin e ri do të shmangen dyfishimet ose rëniet ndesh me përgjegjësitë e organeve tashmë të themeluara sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, nëveçanti Këshillit për Zbatim dhe Monitorim.” Andaj, në vazhdim do të paraqesim problemet dhe mangësitet të cilat synojmë që me plotësim-ndryshim të ligji ti përmirësojmë.

- Fillimisht do të bëhet një përcaktim më i quartë sa i përket statusit juridik te Institucioneve të Trashëgimisë Kulturore dhe në të njëjtën kohë do të bëhet një riorganizim sa i përket kësaj çështje.
- Përmes plotësimit dhe ndryshimit të ligjit do të kërkohet hapja e kodeve buxhetore të këtyre Institucioneve te cilat që nga themelimi i tyre nuk kane kode te veçanta.
- Kemi vërejtur që këto Institucionë kanë nevojë për nga një organ këshillëdhënës të cilin do ta emëroj Ministri i Kulturës.
- Përmes plotësimit dhe ndryshimit te ligjit aktual do shikohet mundësia që të bëhet edhe harmonizimi i tij me legjisacionin e BE-së.

- Do të rregullohet çështja e koncessioneve
- Do të rishikohen gjobat te cilat do të paraqiten përmes plotësimit dhe ndryshimit te ligjit aktual.
- Gjobat që do të parashihen përmes plotësimit dhe ndryshimit të ligjit aktual do të rishikohen dhe harmonizohen me Ligjin përkundër vajtjet.

Kapitulli 3. Synimet dhe objektivat

Investimi ne institucionet e trashëgimisë kulturore, me theks te veçantë ne sistemin e mbrojtjes ligjore është prioritet i MKRS-se. Avancimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore ne fushën e trashëgimisë kulturore do te behet ne përpunje me orientimin e Kosovës kundrejt prioritetave te Partneriteti Evropian dhe anëtarësim ne UNESCO. Duke përfshirë këtu përkushtimin e palëkundur dhe garancitë e dhëna nga institucionet e Kosovës në letrën e vitit 2015 drejtuar të gjitha delegacioneve kombëtare në UNESCO, si edhe Strategjinë kombëtare për trashëgimi kulturore 2017–2027 dhe Ligjin aktual për zonat e veçanta të mbrojtura.

Syndimi

Me ndryshimet e parapara synohet avancim përbajjesor dhe afatgjate i sistemit ligjor dhe institucional te trashëgimisë kulturore ne Kosove. Ne vazhdim, synohet zbatimi efektiv dhe përbajjesor i te gjitha provizioneve ligjore qe rrugollojnë trashëgiminë kulturore ne legjispcionin vendor, valorizimin konform kritereve për Trashëgiminë Kulturore Botërore, vendosja e mekanizmave te monitorimit dhe zbatimit, përfshire dhe rekomandimet e Raportit te Progresit 2015 ne lidhje me zbatim efektiv te politikave dhe legjisacionit ne fuqi

Objektivat

Një ndër objektivat përsore është qe me ndryshimet e parapara te përcaktohen rregullat përmbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Trashëgimisë Kulturore te Kosovës. Të sigurohet ruajtja e karakterit dhe pamjes se vendeve që do të mbrohen, në veçanti, kontekstini historik kulturor, arkitektural dhe arkeologik, mjedisin natyror dhe kuadrit vizual estetik si dhe të parandalojnë zhvillimet e pafavorshme rrëth vendeve që duhet të mbrohen, ndërkohë që sigurojnë kushtet më të mira të mundshme për

zhvillimin e harmonizuar dhe të qëndrueshëm në komuniteteve që banojnë në zonat rreth këtyre vendeve duke rregulluar zhvillimin dhe aktivitetet e tjera.

Politiqa aktuale

Trashëgimia kulturore është një ndër sektorët me prioritet të Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Programin e Qeverisë të Republikës së Kosovës 2017-2021 dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019. Misioni i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore sipas standardeve evropiane, duke e konsideruar trashëgimie kulturore si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit dhe për afirmimin e identitetit kulturor të vendit.

Trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes efektive në avancimin e sistemit të mbrojtës. Strategjia për Trashëgimini Kulturore 2017-2027 e cila synon vodosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë, synon avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përpunëje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Politikat aktuale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit zhvillohen bazuar dhe në kornizën aktuale ligjore.

Në fushën e trashëgimisë kulturore është në fuqi Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore i miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Me këtë Ligi ne veçanti rregullohen çështjet si në vijim:

- Definimi i nocioneve në kontekstin e ligjit;
- Inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e përkohshme e trashëgimisë kulturore;
- Mbrojtja dhe masat legale;
- Obligimet e personave juridik dhe fizik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore;
- Shitja dhe shpronësimi i trashëgimisë kulturore;
- Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore;
- Kategoritë e trashëgimisë;
- Masat paraprake dhe shpëtuese;

- Masat konservuese të mbrojtjes dhe ruajtja e trashëgimisë së luajtshme kulturore;
- Kufizimet legale mbi ekspozimin;
- Qarkullimi i trashëgimisë së luajtshme;
- Sanksionet etj.

Mirëpo, korniza ligore aktuale nuk bënë përcaktimin e qartë sa i përket statusit juridik te Institucioneve të Trashëgimisë Kulturore, ku dhe mungesa e kodeve buxhetore të këtyre Institucioneve vjen si pasoje. Per me tëpër, institucione kanë nevojë për nga një organ këshillëdhënës të cilin do ta emëroj Ministri i Kulturës e qe me ligjin aktual nuk përcaktohet. Me ligjin aktual nuk është e rregulluar as çështja e koncesioneve dhe gjobave.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Kodi penal i Kosovës.

Ligji për Institucionet e Kulturës;

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit;

Ligji për fshatin Hoçë e Madhe;

Ligji për fshatin Zym i Hasit;

Ligji për Trashëgimi Kulturore;

Regullore Nr. 01/2008 mbi Procedurat për Gërmimet/Hulumtimet Arkeologjike

Regullore Nr. 02/2008 mbi Qasjen Publike ne Trashëgiminë Kulturore ne pronësi Private

Regullore Nr. 03/2008 mbi Aktivitetet Konservuese Restauruese te Trashëgimisë Kulturore

Regullore Nr. 04/2008 mbi Autorizimet dhe Kompetencat e Inspeksionit për Trashëgimi Kulturore

Regullore Nr. 05/2008 mbi regjistrimin, dokumentimin, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjidhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje

Regullore Nr. 06/2008 mbi Masat e sigurisë për trashëgimin e luajtshme

Regullore Nr. 07/2008 mbi Procedurat e licencimit për qarkullimin e trashëgimisë se luajtshme

Programi aktual

Programi aktual zhvillohet konform Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, Strategjisë Kombëtare për Trashëgimini Kulturore 2017-2027 dhe politikave afatmesme të MKRS, në kuadër të cilave janë paraparë aktivitetë që derivojnë dhe nga ligji aktual i trashëgimisë kulturore.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimini Kulturore përcaktohen aspektet themelore që në mënyrë të drejtëpërdrejtë synojnë promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, si dhe rritjen e dukshtmërisë së vlerave potenciale të saj. Synimet e Strategjisë mund të përmblidhen si në vijim: [i] Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes - në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligueve tjera relevante dhe angazhimeve të Kosovës, si dhe orientimin e Qeverisë së Kosovës karshi Prioriteteve të Partneritetit European dhe anëtarësimit në UNESCO; [ii] Qasja e integruar në mbrojtje - sipas parimeve dhe trendeve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor; [iii] Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar - me qëllim të nxities së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit. Strategjia ndërtohet mbi qëllimet (objektivat) konkrete. Objektivat e Strategjisë burojnë nga synimet më lartë dhe mbi bazën e analizës së përvojave të kaluara, gjendjes aktuale në domenin ligjor, infrastrukturor dhe programor, si dhe të çështjeve në fushën e trashëgimisë kulturore që bëhen subjekt trajtimi në dhjetëvjetëshin vijues në Kosovë. Objektivi i parë korrespondon me synimin e parë; objektivat 2 dhe 3 burojnë nga synimi i dytë, ndërsa objektivat 4 dhe 5 nga synimi i tretë. Objektivat janë përkufizuar si më poshië: 1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale; 2. Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm; 3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore; 4. Promovimi i trashëgimisë kulturore; 5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Strategjia përcakton qasjet dhe veprimet orientuese për funksionim efektiv të sektorit të trashëgimisë kulturore në periudhën dhjetëvjeçare 2017-2027.

1. Në fushën e avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale, prioritet mbetet investimi në institucionet e trashëgimisë kulturore dhe në sistemin e mbrojtjes në përgjithësi. Paralelisht, avancimi i vazhdueshëm i legjislacionit për trashëgimini kulturore do të përfshijë përvëç ligj bërijës edhe masat që garantojnë harmonizimin me ligjet tjera të Kosovës, si dhe me legjislacionin e BE-së. Në funksion të zbatimit të ligjit, Strategjia përcaktohet për veprimitari të integruar të mbrojtjes në sektorët vital si inventarizimi dhe digitalizimi i trashëgimisë kulturore, menaxhimi dhe monitorimi i gjendjes së trashëgimisë dhe trajtimi i saj kur është e përshtatshme, partneriteti dhe bashkëpunimi ndër sektorial.
2. Qasja e integruar me këtë strategji merr përmasa zhvillimore në gjithë territorin e Kosovës duke e promovuar trashëgiminë kulturore si resurs të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor, në konsultim me aktorët relevantë dhe nëpërmjet

pjesëmarrjes aktive të komuniteteve relevante, përfshirë komunitetet fetare, si dhe pronarët, poseduesit dhe shfrytëzuesit e pronave kulturore, siç është përçaktuar me legjislacionin përkatës dhe angazhimet ndërkomëtare ligjore dhe politikë të institucioneve të Kosovës. Në këtë kuadër, Strategja përcaktohet për krijim të platformave të asocimit dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe multisektorial për ruajtjen dhe menaxhimin efektiv të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e saj në agjendën e Qeverisë së Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm.

3. Objektiv i veçantë dhe sfidues në këtë qasje bëhet përfshirja e trashëgimisë kulturore në plane dhe programe zhvillimore komunale dhe kombëtare. Metodologjia dhe praktikat e mira të konservimit të integruar të cilat promovojnë konkurrencë të lirë dhe të shëndoshë, si dhe nxijen e kreativitetit dhe të inovacionit, do të vihen në shërbim të komunave të Kosovës nëpërmjet avancimit dhe zbatimit konsekuent të dokumentit strategjik të MKRS-së për konservimin e integruar (2010) dhe në harmoni me udhëzimet dhe praktikat ndërkomëtare, të promovuara nga UNESCO, KE, ICOMOS, ICCROM, etj. Cjithashtru, vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore si pjesë e mekanizmit për vlerësim të ndikimit në mëndis do të fuqizohet si mëss që siguron ruajtjen e autenticitetit dhe menaxhimin adekuat të resurseve dhe pronave kulturore.
4. Komunikimi dhe promovimi gjithëpërfshirës i trashëgimisë kulturore dhe i arriteve në fushën e zhvillimit kulturor me këtë Strategji bëhet hallkë vitale e procesit të mbrojtjes dhe njëherë e mëvetësishme, e cila garanton promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Strategja në këtë kuadër shtron si kërkosë studimin e plotë dhe sistematik të trashëgimisë kulturore, si dhe interpretimin objektiv për t'u plusuar në botime dhe mediume virtuale. Në funksion të zbatimit të këtij qëllimi, investimet do të orientohen në përmirësimin e turizmit kulturor dhe të infrastrukturës përcjellëse për interpretim dhe prezantim, si dhe promovim të diversitetit kulturor dhe simbolikës reprezentative të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës.
5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive, në këtë kuadër, do të përkrahet me qëllim të zhvillimit pozitiv të debatit bashkëkohor në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Së këndejmi, do të përkrahet ndërtimi sistematik i kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore, të cilët përbëjnë burimin formal të komunikimit dhe të veprimit pjesëmarrës me publikun e gjérë. Përtej këtij angazhimi dhe duke ruajtur të drejrat e pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të pronave kulturore, Strategjia therrë përmirësim të “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore si e drejtë e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe si kontribut i të gjitha palëve për sigurim të qasjes së papenguar, qe garanton përmirësimin e imazhit Kosovës në sytë e popullatës kosovare dhe të vendeve tjera në botë.

Ndërsa q Planin e punës për vitin 2018 janë paraparë këto prioritetë kryesore:

- Rishikimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- Promovimi dhe mbështetja për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore dhe konservimi i integruar;
- Plotësimi i inventarit të aseteve të Trashëgimisë Kulturore;
- Hartimi i planeve të menaxhimit për asetet e Trashëgimisë Kulturore, projekteve të Intervenimeve Emergjente si dhe projekteve të Restaurimit dhe Konservimit në fushën e Trashëgimisë Kulturore;
- Avancimi dhe plotësimi i data bazës së të dhënave, krijimi i kartelës së Trashëgimisë Shpirtërore

Prioritet e lartpërmendura janë planifikuar të zbatohen përmes Planit Vjetor të Punës, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore.

Shpenzimet aktuale

Cdo vit planifikohen dhe ndahen mijete financiare, në kategorinë e subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve, komunale dhe investimeve kapitale, në fushën e trashëgimisë kulturore:

Buxheti aktual i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore

<u>Buxheti</u>	<u>Viti</u>	<u>Shuma</u>	<u>Viti</u>	<u>Shuma</u>	<u>Viti</u>	<u>Shuma</u>
<u>Pagat dhe mëditjet</u>	<u>2018</u>	<u>763.534.42</u>	<u>2019</u>	<u>776.163.89</u>	<u>2020</u>	<u>761.502.22</u>
<u>Subvencione</u>	<u>2018</u>	<u>842.286.00</u>	<u>2019</u>	<u>842.286.00</u>	<u>2020</u>	<u>842.286.00</u>
<u>Mallra dhe shërbime</u>	<u>2018</u>	<u>15.100.00</u>	<u>2019</u>	<u>15.100.00</u>	<u>2020</u>	<u>15.100.00</u>
<u>Komunali</u>	<u>2018</u>	<u>93.500.00</u>	<u>2019</u>	<u>103.500.00</u>	<u>2020</u>	<u>103.500.00</u>
<u>Investime kapitale</u>	<u>2018</u>	<u>4.020.000.00</u>	<u>2019</u>	<u>3.027.684.00</u>	<u>2020</u>	<u>2.750.000.00</u>
<u>Buxheti total</u>	<u>2018</u>	<u>5.734.420.42</u>	<u>2019</u>	<u>4.764.733.89</u>	<u>2020</u>	<u>4.472.388.22</u>

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale:

Politika aktuale për mbështetjen institucionale të kulturës është hartuar dhe zbatuar nga ana e MKRS-së bazuar në ligjin aktual të trashëgimisë kulturore, dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet respektive.

Duhet cekur se ligji aktual i trashëgimisë kulturore, mbi bazën e të cilat është hartuar edhe politika aktuale në fushën e trashëgimisë kulturore është vlerësuar së duhet ndryshuar me qëllim të harmonizimit me legjislacionin vendor e ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore.

Plotësim ndryshimi i ligjt aktual do të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në politikat aktuale dhe në përcaktimin e statutit juridik të institucioneve, reformës institucionale, çështjes së kodeve buxhetore harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së dhe ndërkombëtar, administrimt të koncesioneve, rishikimit të gjobave etj.

Lidhur me këtë, rekomandohet Plotësim/Ndryshimi i ligjt në fuqi. Ky Plotësim/Ndryshim do të adresonte çështjen e identifikuarë më sipër.

Gjithashtu ky plotësim/ndryshim i ligjt do të mundëson njëherazi që politikat në fushën e trashëgimisë kulturore të jenë në funksion të përbushjes së prioriteteve në fushën e trashëgimisë kulturore sikurse ruajta, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.

Përvoya në shtetet tjera

Në funksion të harmonizimit dhe përafshimit me praktikat, standardet dhe përvojat e shteteve evropiane në fushën e trashëgimisë kulturore, janë konsultuar përvaja dhe korniza ligjore e Slovenisë, Kroacisë, Maltës dhe Italisë.
Bazuar në rastin e Slovenisë, përkatësisht organizmit institucional dhe harmonizimit me Acquis-në e BE-s që, është vlerësuar se legjislacioni sloven mbetet shembulli më i mirë dhe i përshtatshëm për rrithanat kosovare në kontekst të përditësimit të legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore.

Kushtetuta e re e Slovenisë në vitin 1991 ka krijuar të drejta tradicionale në lidhje me kulturën, duke përfshirë lirinë e krijimit artistik, zhvillimin kulturor dhe mbrojtjen e trashëgimisë, si dhe sigurimin e të drejtave të autorit, kulturore dhe gjuhësore për pakicat italiane dhe hungareze, të drejtat për komunitetin rom dhe ndihmën për sllovenë që jetojnë në vendet fqinje ose në mbarë botën.

Akti që rregullon realizimin e interesit publik në fushën e kulturës (2002) tanë është një ligj ombrrellë dhe aktualisht përbëhet nga:çaktimi i rregullave për vendimarrjen e politikës kulturore (transparencë, pjesëmarrje, përgjegjësi, efikasitet, koherencë);miratimi i pesë objektivave kryesore të politikës kulturore;përcaktimin e aktorëve kryesorë (përveç autoriteteve publike);krijimin e disa mekanizmave të posaçmë për hartimin e politikave kulturore (Programi Kombëtar i Kulturës dhe reporti i rregullt vjetor për Parlamentin për zbatimin e tij, tenderët publikë dhe thirrjet për propozime për financim publik, të cilat përcaktojnë

qëllimet, kriteret dhe kushtet për alokimin e fondeve publike, marrëveshjet ndërmjet shtetit dhe komunave që përcaktojnë objektivat e përbashkëta të politikës kulturore); nisjen e sistemit të shërbimeve kulturore publike (kapitull i veçantë lidhur me themelimin, administrimin, funksionimin dhe financimin e institucioneve kulturore publike); financimi i aktiviteve kulturore (fonde institucionale për institucionet publike dhe projektet dhe financimi i programave për OJQ-të); dhe duke përcaktuar të drejtat e artistëve në lidhje me sigurimet shoqërore dhe pensionet.

Ligji bazik në fushën e trashëgimisë kulturore në Slloveni është Ligji për Mbrojten e Trashëgimisë Kulturore. Ky ligj parashikon metodat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe kompetencat përkatëse që kërkohen për një politikë të integruar të ruajties së trashëgimisë. Ndërsa që aspekt institucional Ministrria e Kulturës e Sllovenisë përmes Drejtorisë për Mbrojten e Trashëgimisë Kulturore është përgjegjëse për detyrat e qeverisies në fushën e trashëgimisë kulturore dhe monitoron zhvillimin e sistemit kompleks të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore mbulon fushat e mëposhtme: Trashëgimia kulturore e pasurive të paluajshme, Arkivat dhe Trashëgimia e gjallë (Trashëgimia e paprekshme). Ajo përgatit dhe bashkërendon projektet zhvillimore, kriteret për bashkëfinancimin e programeve kulturore dhe projekteve dherishikimeve; vlerëson aspektet ligjore dhe ekonomike të shpenzimeve të finansimit publik në fushën e arteve dhe ndihmon në formësimin e bazave të të dhënavë të përbashkëta dhe komunikon me publikun sipas regulave. Detyra të veçanta të Drejtorisë përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjisë së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen dhe zhvillimin e shumëlojshmërisë kulturore të Sllovenisë. Drejtoria zbaton kornizën ligjore ndërkombe të që ka të bëjnë me mbrojten e trashëgimisë kulturore dhe është përgjegjës për monumentet kulturore të përcaktuara si pronë shtetërore.

Ndërsa që përket harmonizimit me Acquis-në e BE-së që, Sllovenia ka ligj të veçantë karshi atij bazik (Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore) lidhur me rikthimin e objekteve të marra jashtëligjshëm nga territori i shtetit. Ky ligj (Ligji për Rikthimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Marra Jashtëligjshëm) rrugollon kthimin e objekteve të luajtshme të trashëgimisë kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Sllovenisë dhe janë sjellë në territorin e cilidho shtet që është anëtar i Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejmë: Shteti Anëtar), ose të sjella nga territori i një Shteti Anëtar në territorin e Republikës së Sllovenisë. Me këtë ligj, Direktiva e Parlamentit European dhe e Këshillit mbi kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të jashtëligjshme nga territori i një Shteti Anëtar është transpozuar në rendin ligjor të Republikës se Sllovenise.

Kapitulli 4. Opcionet

Opcioni i 1. Status quo (asnjë ndryshim)

1. Nëse vazhdohet me politikën ekzistuese, e më konkretnisht nuk bëhet plotësimi/ndryshimi i Ligjit aktual për Trashëgimi Kulturore, atëherë çështja e definimit, funksionimit, përcaktimit të përgjegjësive, mbikëqyrjes dhe te njashme do të mbesin pa u trajtuar në nivelin e kërkuar, pasi që korniza aktuale ligjore *nuk ofron menjveshëm* hapësirë për definimin dhe rregullimin e çështjeve të cekura më sipër.
2. Në anën tjetër, nëse vazhdohet me status quo, përkufizimi i çështjeve të sipër cekura, do të mbesin gjithashtu çështje të pa trajtuarë.
3. Aktualisht fusha e trashëgimisë kulturore rregullohet sipas Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, Ligjit për Zonat e Veçanta te Mbrojtura, Ligjit për Qendrën Historike te Prizrenit dhe Ligjit përfshatin Hoqe e madhe. Për zbatimin e ligjeve të larë cekura dhe akteve tjera nënligjore janë përgjegjëse institucionet me sa vijon: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore, etj.

Opcioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese

1. Politika ekzistuese mund të ndryshohet nëse fillohet me plotësim/ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, me qëllim të rregullimit të fushës përkatëse Krahas dhe praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në këtë lëmi. Njëherazi vjen theksuar që plotësim/ndryshimi i ligjit në fuqi do të paraqiste edhe një obligim të përbushur në kuadër të procesit të integrimit evropian, e më specifisht rekomandimeve të dala nga Raporti për Vendin. Për më tepër, plotësim/ndryshimi i ligjit është veprim i paraparë në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA). Ndërkao sa i përket harmonizimit me Acquis-në e BE-së në fushën e trashëgimisë kulturore, pas miratimit të Projektitligji për Trashëgiminë Kulturore është planifikuar nxerra e ligjeve sikurse Ligji për Rikthimin e Objekteve të Marra Jashtëligjishëm dhe Ligji për Eksportin e të Mirave Kulturore duke transponuar kështu Direktivën 2014/60/EU mbi Rikthimin e Objekteve Kulturore të Marra Jashtëligjishëm nga Territori i Shtetit Anëtar dhe Rregulloren 116/2009 mbi Eksportin e të Mirave Kulturore.
2. Projektligji për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore do të kishte këtë përbajje dhe do të rregullonte fushat me sa vijon:

- Përkufizimi;
 - Kategoritë e trashëgimisë kulturore;
 - Procedurat për gërmim arkeologjik dhe ndërhyrje konservuese restauruese;
 - Inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e përkohshme e trashëgimisë kulturore;
 - Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore;
 - Institucionet e Trashëgimisë Kulturore;
 - Koncessionet-Shija dhe shpronësimi i trashëgimisë kulturore;
 - Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore;
 - Sankzionet;
 - Procedurën e ankimit;
 - Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.
3. Për zbatimin e Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore do të jenë përgjegjëse këto institucione:
- Ministria e Kulturës, Rinasë dhe Sportit e cila është kompetente dhe obligohet për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit;
 - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - Këshilli për Zbatim dhe Monitorim
 - Këshilli i Kosovës për Trashëgimini Kulturore;
 - Komunat.
 - Këshillat e trashëgimisë kulturore të Prizrenit dhe fshatit Hoçë e Madhe, si organë gjegjëse për zbatimin e Ligjit për trashëgimi kulturore

Detyrat dhe përgjegjësit e secilit institucion te përfshire ne ruajten, mbrojten dhe menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore do te përcaktohen me Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88, nëse nuk janë të rieggulluara ndryshe.

4. Dënimet/ sanksionet për mosrespektimin e Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88.

5. Në kuadër të Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, është përcaktuar niveli formal i kualifikimit për personelin profesional të muzeut. Gjithashtu janë paraparë forma të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve për stafin në funksion të ngritjes së profesionalizmit.

6. Ka nevojë për program shtesë lidhur me kërkosat specifike për provimin profesional të stafit profesional, kriteret dhe procedurat e të cilët do të përcaktohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

7. Në kuadër të procesit të hartimit të kornizës ligjore, respektivisht hartimit të Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, Departamenti për Trashëgimi Kulturore pranë MKRS, në kuadër të Planit Vjetor të Punës ka paraparë realizimin e fushatave edukuese dhe vetëdijesuese pikërisht lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe ndryshimet ligjore në këtë drejtim.

Fushata do të realizohej përmes kampanjave informuese, dhe për realizimin e saj përgjegjëse është MKRS, respektivisht Departamenti për Trashëgimi Kulturore dhe institucionet vartëse. Fushata do të mbuloj të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe do të zgjasë deri kur te aprovohet Projektligi për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës .

8. Për zbatimin e ligjit do të jenë institucionet e njëjta të evidentuara në pikën 3 të opsjonit 2.

9. Ka nevojë për përgatitje shpesë, hartimi i ligjit pos që kërkon vazhdim të punëve dhe përgjegjësive të ushtruara në aplikimin e legjisacionit, parashë edhe krijimin dhe konsolidimin e mekanizmave të rinj dhe atyre ekzistues si dhe vazhdimin e ngritis profesional për personelin profesional të muzeve.

Opsioni i 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

1. Nëse nuk plotësohet/ndryshohet Projektligi për Trashëgimi Kulturore dhe vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese, nuk ka alternativë apo mënyrë tjeter për të rregulluar çështjet e pa trajtuarë më detajishë gjer më tanë në fushën respektive. Mënyra e ndryshuar e zbatimit të legjisacionit nuk ofron zgjidhje të problemit.
2. Për mos përbushjetë obligimt të marrë sigurisht se përgjegjës do të ishte fillimisht MKRS, por edhe Qeveria e Kosovës.
3. Trajinimet dhe programet tjera për qasjen ekzistuese të zbatimit nuk do të kanë efekt në adresimin e problemit. Adresimi i problemit bëhet vetëm me hartim të Ligjit për Muzetë.

Kapitulli 5. Përbledhje e opsiioneve

Përbledhje e Opsoioneve			
Karakteristika kryesore	Opcioni 1	Opcioni 2	Opcioni 3
Karakteristikat kryesore opsionit	të - Ruajtja e status quo	- Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore - Përbushje e obligimeve të dala nga procesi i integrimit evropian	Politika mund të ndryshohet nuk mënyrë tjetër Dështim i përbushjes së obligimeve ligjore
Segmenti popullsisë/sektori/rajoni shënjestruar	i - Qytetarët e Republikës së Kosovës	- Qytetarët e Republikës së Kosovës	- Qytetarët e Republikës së Kosovës
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Administrimi ose zbatimi programit ose shërbimit	i - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ligjet, aktet ndryshimet dhe plotësimet e ligjive ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	nënligjore, - Ligji për Trashëgiminë Kulturore; - Ligji për Institucionet e Kulturës - Ligji për Zonat e Vëçanta te Mbrojtura - Ligji për Qendrën Historike te Prizrenit - Ligji për Fshatin Hoqe e Madhe	- Plotësim/Ndryshimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore - Ligji për Institucionet e Kulturës	- Ligji për Trashëgiminë Kulturore; - Ligji për Institucionet e Kulturës

Stimulimet ose mos- ekonomike – subvencionet ose taksat	- Nuk ka ndikime	- Nuk ka ndikime
Fushatat e edukimit komunikimit	<p>- Nuk ka nevojë fushatë komunikimi, fushata janë bërë në vazhdimesi gjatë procesit të zbatimit të kornizës ligjore në fuqi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi për koncept dokumentin është bërë duke zbatuar Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës 09/2011 si dhe Rregulloren për procedimin minimal të konsultimeve publike, janë konsultuar institucionet e përcaktuara me ketë rregullore. - Edukimi dhe promovimi do të behët pas aprovizimit të koncept dokumentit dhe posaçërisht pas hartimit të Projektligjit për Muzejet.

Kapitulli 6. Analiza e opzioneve

Përfitimet

1. Opzioni i 1 (parë), (status quo): Sipas opzionit 1 përfitme do të jenë vetëm ato që kanë qenë gjer më tanë, përkatësish ato që kanë deriuar nga zbatimi i kornizës aktuale ligjore.

2. Opzioni i 2 (dytë): Përmes këtij opzioni, përkatësish plotësim/ndryshimit të Projektligjit për Trashëgimi Kulturore do të bëhen përkufizimi i menaxhimit të fushës se trashëgimisë kulturore zbatimit të standardeve të praktikës profesionale dhe shumë çështje të rëndësishme të sektorit të trashëgimisë kulturore. Gjithashtu vlen theksuar, që plotësim/ndryshimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore do të paraqiste edhe një obligim të përbushur në kuadër të procesit të integrimit evropian, e më specifisht rekomandimeve të dala nga Raporti për Venden dhe Konkluzionet finale nga takimet e Nën Komitetit për Inovacion, Shoqëri Informativë dhe Politika Sociale të si dhe veprimeve të paraparë në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA). Së

fundmi plotësim/ndryshimi i ligji aktual do të kishtë impakt rë theksuar në avancimin e sektorit të trashëgimisë kulturore krahas praktikave dhe standardeve ndërkombëtare në flushën e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, plotësimet dhe ndryshimet adekuatë Ligjt për trashëgimi kulturore do të mundësojnë që të respektohen dhe realizohen zotimet dhe garancitë e palëkundura të bëra nga institucionet e Kosovës në letrën e tyre të vitit 2015 drejtar të gjitha delegacioneve kombëtare në UNESCO

3. Opsiuni i 3 (tretë): Nëse ligji nuk ndryshohet vazhdohet me zbatimi e politikës ekzistuese.

Pasojet negative

- 1. Opsiuni i 1 (parë) -** Ndjikime negative do të evidentohen kryesisht ato që ndërlidhen me mos definimin dhe përcaktimin e shumë çështjeve të rëndësishme përfshirë fushën e trashëgimisë kulturore.
- 2. Opsiuni i 2 (dytë). -** Nuk ka pasoja negative nëse vendoset sipas këtij opzioni.
- 3. Opsiuni i 3 (tretë). -** Vlen i njëjti përshtkim i pasojave negative si në opzionin e parë.

Efekti shpërndarës

1. Hartimi i Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturore sjellë përfitime për institucionet qendrore, lokale, shoqërinë civile e para se gjithash qytetarët e vendit.
2. Përfitimet dhe pasojet negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opzionet e konsideruara nuk janë të lidhura me rajone apo pjesë të caktuar të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e vendit.
3. Ndikimet e opzioneve të konsideruara janë të njëjta për të gjitha moshat dhe veprojnë njëjtë në të dy gjinitë, pra nuk ka efekte dalluese në baza të gjinive apo moshës.

Kosto

Për implementimin e këtyre opsjoneve të propozuara nuk krijoen kosto shtesë buxhetore përvç atyre të parapara tashmë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2018. Vazhdimi i aplikimit të politikave aktuale dhe ndryshimi i politikave aktuale nuk paraqet ndryshime në shpenzimet buxhetore.

Për më tepër, asnjëri nga opsjonet e hartuara nuk paraqet diferençë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve.

Kapitulli 7- Konsultimi

Për të siguruar konsultime të mirëfillta dhe gjithëpërfshirëse, Draftligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjt për trashëgjimi kulturore do të shpërndahet në të dyja gjuhjet zyrtare.

Konsultimi me ekspertë dhe institucionet e trashëgimisë kulturore do te bëhen sikurse me poshtë :

1. Muzeu i Kosovës;
2. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës;
3. Instituti Arkeologjik i Kosovës;
4. Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore;
5. Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore.

Konsultimi me Ministritë tjera:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Këshilli i Kosovës për Trashëgimini Kulturore.

Konsultimi me palët tjera te interesit:

- Bashkësítë fetare;
- Pronarët e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare
- Këshillat për trashëgimi kulturore të Prizrenit dhe fshatit Hoçë e Madhe

Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile:

- Konsultimet me akterët kryesor të shoqërisë cilivile në fushën e trashëgimisë kulturore.

Kapitulli i 8: Krahasimi i opsiioneve (vlerësimi i pasojave të seilit opsim)

1. Përfitimet sipas opsimit të parë të ndërlidhura me ruajtjen e gjendjes ekzistuese janë kryesisht ato qfarë kanë ekzistuar gjer më tanë. Ndërsa pasojat negative, do të reflektohen shin kryesisht në mosdefinimin dhe përcaktimin e çështjeve të shumta të rëndësishme si definimi i statusit te institucioneve publike si dhe detyrat dhe përgjegjësitet e tyre.

2. Opsiioni i dytë do të sillte më shumë përfitime, lidhur me këtë mund të thuhet se vështirë do të ishte të gjendet ndonjë efekt negativ. Ndërsa, sa i përket efekteve pozitive, ato do të janë të shumta duke filluar nga përkufizimi i fushë veprimtarisë, plotësimi i kornizës institucionale, definimit dhe menaxhimit të koleksioneve muzeore, regjistrat të muzeve, zbatimit të standardeve të praktikës profesionale për stafin e muzeve dhe shumë çështje të rëndësishme të sektorit muzeor. Gjithashtu vlen theksuar, që plotësimi/ndryshimi i ligjit do të paraqiste edhe një obligim të përbushur në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe së fundmi e që rrjedhimisht do të kishte impakt në mundësië e krijuara për zhvillimin dhe profesionalizimin e fushës respektive duke ofruar mundësi dhe zgjidhje më praktike për avancimin e sektorit në fjalë.

Opsiioni i dytë ka efekte pozitive të shpërndarjes. Shpërndarja dhe efektet e saj sipas opsimit të dytë nuk do të bëjnë dallime në aspektin rajonal apo territorial, por përfshijnë tërë territorin e Kosovës. Efektet nuk kanë dallime të cilat mund të ndjehen nga grupe të caktuara bazuar në moshe apo në gjini.

3. Opsiioni i tretë do të kishte përfitime të njëjta me opsimin e parë, duke pas parasysh që ndryshimet vetëm në qasjen e zbatimit të ligjit nuk do të prodhonin ndryshme në përfitimet e elaboruara në opsimin e parë, por edhe efekti i pasojave negative do të ishte i njëjtë dhe efektet e shpërndarjes do të ishin të njëjta me opsimin e parë, të ndërlidhura me ruajtjen e status quo.

4. Opsiioni i dytë i cili parashëh plotësimin/ndryshimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturore do të ishte opsimi më i qëlluar dhe i rekomanduar për arritjen e synimit dhe objektivave të parapara në pjesën 3.

Kapitulli 9: Rekomandimi

1. Rekomandohet opzionin i dytë, respektivisht plotësim/ndryshimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore, me qëllim të regullimit të shumë çështjeve të rëndësishme përfushën e trashëgimisë kulturore si dhe me qëllim të përbushjes së obligimeve të dala nga procesi i integrimit evropian, duke marrë përfazë praktikat më të mira evropiane dhe ndërkontëtare.
2. Procedurat për hartimin e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rimisë dhe Sportit, Departamenti për Trashëgimi Kulturore, si akter kryesor, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit që të arrihen objektivat e parapara.
3. Brenda vitiut 2018 duhet të përfundoj procedura e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore.
4. Kosto (Zyra për Buxhet dhe Financa/MKRS).

Buxheti aktual i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore:

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore					
Buxheti	Viti	Shuma	Viti	Shuma	Viti
Pagat dhe mëditjet	2018	763,534.42	2019	776,163.89	2020
Subvencione	2018	842,286.00	2019	842,286.00	2020
Mallra dhe shërbime	2018	15,100.00	2019	15,100.00	2020
Komunali	2018	93,500.00	2019	103,500.00	2020
Investime kapitale	2018	4,020,000.00	2019	3,027,684.00	2020
Buxheti total	2018	5,734,420.42	2019	4,764,733.89	2020
					4,472,388.22

5. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit do të formohet ekipi punues për hartimin e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, i cili do të përcjell informatat e përditësuara lidhur me procesin e hartimit të projektligjit në fjalë.

Kapitulli 10: Komunikimi

1. Akterët kryesorë të fushës janë në dijeni për fillimin e procedurave lidhur me hartimin e Koncept Dokumentit për Trashëgimi Kulturore. Ata do të janë të njoftuar për çdo veprim të ri në këtë aspekt përmes shkresave zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët e prekur do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me aktë ligjore dhe nën-ligjore, varësisht nga fazë e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

11. Projekt vendimi i Qeverisë

1. Aprovohet Koncept-dokumenti i Ministrisë së Kulturës, Rinasë dhe Sportit për Trashëgiminë Kulturore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinasë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim më Regulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.